



In medias res

Risitë, modalitet ndryshimi për përparim të vazhdueshëm të arsimit

Koha postmoderne që karakterizohet si kohë e ndryshimeve të mëdha, të shpejta, të ndërlikuara. Në kohën postmoderne në vend të koherencës përballemi me inkoherencën, në vend të thjeshtësisë përballemi me ndërlikueshmërinë apo kaosin, në vend qëndrueshmërisë e kemi pasigurinë.

Mënyrat dhe mjetet e vetme për të sfiduar kohën postmoderne janë **dijet dhe risitë me të cilat rritet rentabiliteti dhe produktiviteti jo vetëm i sistemit të arsimit për i të gjitha fushave të tjera të jetës në natyrë dhe në shoqëri**. Për këtë arsye, dijet dhe risitë sot konsiderohen kapitali kryesor dhe i vetëm i secilit vend dhe secilit komb.

Me risi nënkuptohet çdo gjë e re në organizim, në përmbajtje, në planifikim, në zhvillim, në monitorim, vlerësim në raportim që përherë të parë zbatohet në një institucione dhe që prodhon avancime dhe ndryshime pozitive përfitues të cilës është institucioni dhe shoqëria. Risia mund të mos jetë plotësisht e re. Ajo mund të jetë zbatuar diku tjetër, por nëse ajo planifikohet dhe projektohet për zbatim për herë të parë në një institucion dhe prodhon ndryshime pozitive në rentabilitet dhe produktivitet, megjithatë ajo është risi apo inovacion.

Risia mund të jetë në formën e **zbulimit** dhe të **shpikjes**. Me **zbulim** nënkuptohet veprimtaria e planifikuar dhe sistematike me të cilën konstatohet ligjshmëria kauzave që ekziston ndërmjet dy e më shumë ndryshoreve, fenomeneve, ngjarjeve a të proceseve e cila ligjshmëri deri në atë moment ka qenë e panjohur dhe e pa vërtetuar. Zbulimet mund të jenë edhe të rastësishme. P.sh. Mund të ndodhë që në nxënësit e një paraleleje të kenë qenë shumë të motivuar për mësimin lëndës së matematikës. Por për një herë në klasë bie interesimi për këtë lëndë. Mësimdhënësi ka humbë vullnetin për punë. Nuk e ka përkushtimin. Ndjehet i lodhur i zbehtë. Është nevrrik. Është agresiv. Fyen dhe ofendon nxënësit. Në procesin e monitorimit udhëheqësi i shkollës konstaton ndryshime të madhe në klasë. Mësimdhënësi nuk është ai që ka qenë. Është i frustruar, i pa përqendruar. Në intervistë gjatë analizës së orës, drejtori konstaton se mësimdhënësi ka frikë se është i sëmurë nga një sëmundje e rrezikshme. Drejtori duke konstatuar këtë gjendje, merr masa të inkurajimit dhe të përkrahjes së mësimdhënësit, apo masa të tjera me të cilat parandalohet rënia e mëtejme e suksesit të klasës apo të paraleles dhe rritjen e shkallës së aspiracionit dhe të motivacionit të mësimdhënësit, apo zëvendësimit të tij me një mësimdhënësi tjetër nëse gjendja e shëndetit të mësimdhënësit është tillë sa që ai nuk mund t'u përgjigjet kërkesave dhe standardeve të shkollës. Zbulimet janë rezultat i hulumtimeve që duhet të bëhen në institucione arsimore. Ato sot janë domosdoshmëri sepse pa hulumtime qofshin ato praktike, teorike, operative, studime të rastit, transversale apo longitudinale, të mëdha ose të vogla nuk mund të dihen ligjshmëritë ndërmjet veprimeve dhe të arritjeve- rezultateve. Për këtë arsye thuhet se mësimdhënia është art, mjeshtri dhe shkencë

Format tjetër e risive janë shpikjet. Shpikjet janë produktet materiale, artificiale të krijuara nga njeriu. Televizori, projektori, mjetet tjera audiovizuale, etj. janë shpikje. Me këto shpikje ndihmohet procesi i të kuptuarit të mësimdhënies dhe të nxënësit. Kështu, p.sh. përdorimi i internetit në mësim është i sigurt se ngrit cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësit sepse nxënësit kanë burime tjera të llojllojshme të informacionit.

Shkroi: Halim Hyseni

(vazhdon)

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit nëntor, 18 mësimdhënës të Sh. f. "Isa Boletini" të fshatit Boletini të komunës së Zveçanit dhe Sh.f. "Kadri Bistrica" të fshatit Bistricë të komunës së Leposaviqit kanë përfunduar trajnimin në kuadër të Programit të MKLSH-së. Kështu më 1 nëntor është mbajtur takimi gjysmë ditor, në të cilin trajnerët kanë analizuar orët e monitorimit. Nga raportet e trajnerëve shihet se mësimdhënësit kanë përparuar në zbatimin e metodologjisë në klasat e tyre. Seminari i fundit në kuadër të MKLSH-së është mbajtur më 8-9 nëntor, ndërsa ceremonia e certifikimit është organizuar më 9 nëntor 2008. Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të zyrës së OSBE në Mitrovicë, përfaqësues të KFOR-it, si dhe shumë veteranë të arsimit.

■ Më 8-9 nëntor dhe 15-16 nëntor janë mbajtur seminarët e dyta me titull "Zhvillimi i Mendimit Kritik" për 8 grupe të MKLSH-së që kanë filluar trajnimin në shtator të këtij viti. Me 8-9 nëntor janë mbajtur trajnimet në Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Gjilan dhe Ferizaj. Ndërsa më 15-16 nëntor është mbajtur trajnimi për grupet e dyta në Prishtinë dhe Gjakovë. Nga raportet e trajnerëve shihet se grupet e mësimdhënësve kanë filluar të përvetësojnë metodologjinë e MKLSH dhe të fillojnë ta zbatojnë atë në klasa. Në fund të seminarit mësimdhënësit janë njoftuar se seminari i tretë do të mbahet më 6-7 dhjetor për grupet e para dhe 13-14 dhjetor për grupet e dyta.

Hap pas Hapi

■ Gjatë këtij muaji janë organizuar 5 punëtori dyditore për edukatorët e Institucioneve parashkollore. Këto punëtori u organizuan nga "Save the Children. Temat për këto punëtori ishin "Individualizimi dhe Shfrytëzimi i materialeve ricikluese si mjete didaktike në klasë". Punëtoritë u organizuan në disa qytete: në Kamenicë, 8 dhe 9 nëntor, Prishtinë, 8 dhe 9 nëntor, Prizren 15 dhe 16 nëntor, Pejë, 22, dhe 23 nëntor dhe Obiliq më 26,27 nëntor.

Gjithashtu, gjatë muajit nëntor kanë vazhduar monitorimet nëpër institucione të ndryshme shkollore dhe parashkollore, të cilat punojnë me metodologjinë Hap pas Hapi.

Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Projekti po realizohet sipas planit të paraparë. Gjatë muajit nëntor ka vazhduar evidentimi i të dhënave të hulumtimit të gjendjes së të drejtave të fëmijës në Kosovë, dhe të vlerësimit të shpejtë të efikasitetit dhe të efektivitetit të punës së Komiteteve Shkollore dhe të këshilltarëve-mësimdhënësve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në shkollat e Kosovës.

■ Gjatë muajit nëntor, në një bashkëpunim të shkëlqyer me UNICEF-in për herë të parë në Kosovë, në prag të 20 Nëntorit – Datës së miratimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, është organizuar Panairi Kosovar për të Drejtat e Fëmijës, në të cilin kanë marrë pjesë MASHT dhe 12 organizata të tjera joqeveritare. Pjesëmarrësit në Panair, në mënyre unanime kanë kërkuar që

organizimi i këtij Panairi të jetë TRADICIONAL.



Panairi është mbuluar mirë nga mjetet e Informacionit.

Nga Panairi, kanë dalë rekomandime të cilat i kontribuojnë jo vetëm në ndërtimin rrjetit mbrojtës të drejtave të fëmijës, por edhe në vetëdijesimin e shoqërisë kosovare për rolin dhe rëndësinë e krijimit të mjediseve të sigurta Kosovare.

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim II është zgjatur edhe për tre muaj. Disa fonde të pashfrytëzuara nga ky projekt deri tash, do të shfrytëzohen për të financuar projektet e më shumë se 30 shkollave në tri rajonet në të cilat shtrihet projekti: Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë. Prandaj rreth 32 shkolla janë përzgjedhur për të marrë pjesë në vazhdimin e këtij projekti.

■ Gjatë muajit nëntor janë zhvilluar trajnimet në dy programe: Plani Zhvillimor i Shkollës dhe Planifikimi i Projekteve Shkollore. Pjesëmarrës në trajnim ishin pjesëtarët e këshillave të shkollave pjesëmarrëse. Këto trajnime i shërbejnë shkollat pjesëmarrëse që sa më mirë të hartojnë planet zhvillimore të shkollës dhe projektet shkollore. Projekti është në fazën e përgatitjes së planeve

zhvillimore të shkollës dhe projekt-propozimeve. Kjo fazë do të pasohet me shqyrtimin dhe aprovimin e këtyre propozimeve në nivelin lokal nga Ekipeve Komunale për Grantet Shkollore dhe në nivelin qendror nga Këshilli për Aprovimin e Projekteve Shkollore. Këto aprovime pritet të ndodhin në fillim të vitit 2009

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Në kuadër të projektit “Monitorimi i Implementimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve RAE në Arsim”, muaji nëntor ka qenë muaji i shumë aktiviteteve.

Aktiviteti social: Më 31 tetor u mbajt një aktivitet social në kuadër të projektit “Monitorimi i Implementimit të Strategjisë RAE në Kosovë”. Ky aktivitet u mbajt në Komunën e Fushë Kosovës me një numër rreth 35 fëmijë e të rinj të komuniteteve RAE. U zgjodh pikërisht kjo datë duke ditur se 31 tetori është festa e “Halloween”. Fëmijët të maskuar defiluan rrugëve të qytetit. Po ashtu u organizua edhe një debat me këta fëmijë i cili debat u mbajt në Shtëpinë e Kulturës në Fushë Kosovë dhe zgjati rreth dy orë.

■ Aktivitetet tjera sociale janë mbajtur edhe në:

Rajonin e Gjilanit- fëmijët kanë pasur aktivitetin në fushë ku kanë bërë lojëra të ndryshme sporti. Ata zhvilluan aktivitetin ku të përfshirë ishin 30 fëmijë nga klasa e 5- 8 te shkollës fillore dhe 3-4 aktiviste nga këshilli i prindërve.



Me datën 23 Nëntor, realizuam aktivitete sociale për fëmijët e komuniteteve RAE, të cilët u mbajt në Komunën e Mitrovicës në një qendër për komunitete RAE në Lagjen e romëve.

Ky aktivitet social u realizua në bashkëpunim të ngushtë me OJQ-GAGA. Në këto aktivitete sociale morën pjesë 25 fëmijë të komuniteteve RAE

■ Të rinjtë e klasës 6,7,8, e shfrytëzuan këtë aktivitet social në këtë qendër që zhvillojnë programe të ndryshme rinore duke përfshirë këtu edhe gara me vizatime.

Tek fëmijët u dërgua mesazhi që të jenë sa më aktiv, bashkëpunues dhe të mësojnë dhe punojnë për një të ardhme të mirë



Sipas komisionit vlerësues, u ndanë 3 shpërblime për punimet më të mira:
Vendi i parë: Argjend Sylejmani, kl. VIII
Vendi i dytë: Raza Paqkollli, kl. VI
Vendi i tretë: Sadik Hashani, kl. VIII

Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

■ Gjatë këtij muaji janë kryer disa vizita në terren. Qëllimi i vizitave ka qenë për t'i parë nga afër ecurinë e aktiviteteve të qendrave, dhe në përgjithësi punën e qendrave, dhe për t'iu ofruar ndonjë ndihmë apo konsulentë. Këto vizita janë zhvilluar edhe në mjediset tjera ku zhvillohen aktivitetet e projekteve. Gjatë vizitave ka pasur edhe shumë takime me përfituesit e projekteve.



Gjatë këtij muaji është mbajtur takimi me tre qendrat. Në këtë takim u shpалos puna e qendrave, u diskutua për bashkëpunimin e mëtutjeshëm, si dhe kishte një shkëmbim të përvojave në mes të qendrave.

KOSOVISION Contest

■ Gjatë muajit nëntor të gjitha shkollat, respektivisht klasat e pesta në shkollat e Kosovës, kanë bërë punën më të madhe me finalizimin e posterave dhe projekt ideve të cilat do të zhvillojnë gjatë muajve në vijim. Këto punime i kanë punuar diku rreth 1300 klasa të pesta të cilat, pas dorëzimit të punës janë pajisur me certifikata për punën të cilën e kanë bërë. Nga të gjitha këto punime, disa janë

përzgjedhur si fituese të kësaj faze. Pra, 50 klasa nga regjione të ndryshme të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Gjiilan, Ferizaj e Mitrovicë) u shpallën fituese më 22 nëntor 2008. Fituesit janë zgjedhur sipas kriterëve të parapara në projekt dhe secili Regjion ka pasur edhe ekipin vlerësues i cili ekip ka vlerësuar punimet dhe projekt idetë më të mira.

Më 29 nëntor është mbajtur edhe dita finale ku të gjitha klasat fituese kanë qenë pjesëmarrëse në një eveniment shumë të madh i cili u mbajt në Pallatin e Rinisë, Kulturës dhe Sportit, në Prishtinë. Aty nxënësit fitues u shpërblyen me dhurata e po ashtu u shpallën edhe tre fitues të rastësishëm, pra me short si më të mirët e projektit. Ata janë: Klasa V1-shkolla fillore "Jusuf Gërvalla", Kaçanik me mësuesen Feride Bunjaku; Klasa V2 nga shkolla "Emin Duraku", Gjakovë me mësuesen Leonora Xërxa dhe klasa V3 nga shkolla "Eqrem Qabej", Burim - Komuna e Malishevës me mësues Rrustem Berisha.



Punimet e nxënësve kanë qenë të ekspozuara nga data 29 nëntor deri më 3 dhjetor kur edhe u bë mbyllja e ekspozitës.

(Shiko Galerinë për më shumë fotografi)

www.kosovision.org

Cilësia e arsimit në regjionin e Dukagjinit (AVSI-CESAL)

- Qendra për Arsim e Kosovës ka përfunduar përpilimin e pyetësorëve. Pyetësorët janë përgatitur për të gjithë mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave fillore të Regjionit të Pejës dhe të Gjakovës. Gjatë këtij muaji është ngritur një grup ekspertësh nga KEC dhe organizata CESAL, me qëllim të përzgjedhjes së mostrës që do të shfrytëzohet në këtë hulumtim.

Përgatiti: Petrit Tahiri